358. **Petrota Gaetano**, *Studi di storia della letteratura albanese: Popolo, Lingua e Letteratura Albanese*, Albanica 18/1, a cura di Matteo Mandalà, A.C.Mirror, Palermo 2003 (37)
359. **Petrota Gaetano**, *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo 2003 (31)
360. **Pezzotta Franco**, **Pugliese Fernanda**, *San Giorgio e Skanderbeg – Shën Gjergji e Skënderbeu*, Montecilfone 2002 (9)
361. **Phoenix**, *e përkohshme kulture*, - boton Qendra e studimeve shqiptare E.Koliqi -, Shkodër, viti VI,nr.4-6, 2002 (19)
362. **Pisarra Filippo**, *Vita quotidiana in una comunità arbëreshe, - poesie -* Edizioni Prometeo, Castrovillari 2007 (58)
363. **Podrimja Ali**, *Eni vjen prej Çamërie*, Rozafa Prishtinë-Arbëria-Tiranë 2004 (30)
364. **Podrimja Ali**, *Litari i ankthit, poezi të zgjedhura*, Toena, Tiranë 2002 (18)
365. **Profeta**, *radhua i hapët: kroi e dhromi*, nr.1, drejtor Giuseppe Schirò Di Modica, Piana degli Albanesi 2006 (48)
366. **Pugliese Basilio**, *K'shita a fjsmi na - proverbi, cantii e poesie*, a cura di Costantino Bellusci e Franco Pugliese, col patrocinio del Comune di San Basile, Grafica Pollino, Castrovillari 2011 (69)
367. **Pugliese Fernanda** (a cura di), *Tra storia e leggenda – Rozafat – racconto arbëresh*, Montecilfone 2004 (48)
368. **Pugliese Martino**, *Kujtimi i motit antiku (Ricordo del tempo antico)*, a cura di Maria Laurito, FT Stampa, Spezzano Albanese 2006 (54)
369. **Riza Selman**, *Vepra të zgjedhura*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2009 (65)
370. **Rocchi D.Antonio**, *Storia e vicende del Monastero di S.Maria di Grottaferrata*, - trad. dal latino a cura di p. Basilio Intrieri, Scuola tipografica italo-orientale di S.Nilo, Grottaferrata 1998 (5)
371. **S.Giovanni Damasceno**, *Paraclitica – Inni alla madre di Dio -*, traduzione dal greco a cura di p. Basilio Intrieri, Monastero Esarchico S.Maria di Grottaferrata, Scuola Tipografica italo-orientale diSan Nilo, Grottaferrata 2001 (5)
372. **Samara Miço**, *Fjalorth krahinor me fjalë shqipe*, Mesonjëtorja, Tiranë 2005 (48)
273. **Santori Frangjisk Anton**, *Emira – dramë në pesë akte*, përshtatje në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, redaktoi Klara Kodra, Argeta LMG, Tirana 2006 (59)
374. **Sarro Italo**, *Pianiano, un insediamento albanese nello Stato Pontificio*, S.E.D. editore, Viterbo 2004 (31)
375. **Sarro Italo**, *La Madonna del Buon Consiglio*, in “Hylli i Dritës”, revistë tremujore / votër kulture shqiptare, 3, Shkodër 2006 (51)
376. **Sarro Italo**, *Shpërngulja e familjeve të Hotit në vitin 1833*, in “Hylli i Dritës”, revistë tremujore themelue në vitin 1913 prej At Gjergj Fishtës, vjeti XXIX, nr.1-2 (260-261), Shkodër 2009 (63)
377. **Sauku-Bruçi Merita**, *Elena Gjika e Girolamo De Rada – lettere di una principessa*, studio introduttivo, trascrizione e note, Edizioni Bargjini, Tirana 2004 (39)
378. **Schirò Demetra Giuseppina**, *Un manoscritto autografo di Marco La Piana / Hora e Arbëreshëvet: denominazioni storiche e letterarie*, in “Biblos”, nr.25, Piana degli Albanesi 2004 (28)
379. **Schirò di Maggio Giuseppe**, *Udha e mbarë*, Salvatore Sciascia Editore, Hora e Arbëreshëvet 2001 (12)
380. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Teatri im Arbëresh – Tri vepra*, Ombra Gvg, Tiranë 2008 (68)
381. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Paja – La dote, opera originale in tre atti*, Quaderni di Biblos, Palermo 2010 (68)
382. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Trimdita, poezi dygjuhësh /Gjorneroe, poesia bilingue*, Pitti Edizioni, Palermo 2009 (68)
383. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Tri vepra të shkurtra, opere teatrali*, Quaderni di Biblos, Palermo 2010 (68)
384. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Lufja e mivet me brethqit – La guerra dei topi e delle rane*, Quaderni di Biblos, Pitti, Palermo 2009 (68)
385. **Schirò Di Maggio Giuseppe**, *Shumë vizita – Molte visite, opera teatrale*, Quaderni di Biblos, Palermo 2009 (68)
386. **Schirò Di Maggio Zef**, *Atje kam – vjersha dygjuhësh (La mia Morea, versi bilingui)*, S.Sciascia Editore, Caltanissetta 2004 (35)
387. **Schirò di Maggio Zef**, *Ishuj, poezi*, përgatiti për botim Nasho Jorgaqi, Ombra GVG, Ura e vjetër, Tirana 2007 (54)
388. **Schirò Di Maggio Zef**, *Metaforë, vjersha / Metafora, poesie*, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta 2005 (43)
389. **Schirò Di Maggio Zef**, *Poesia d'amore in tempo di morte – Kosova martire secondo trimestre '99 – testi poetici bilingui -*, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta 2000 (37)
390. **Schirò Di Modica Giuseppe**, *Ujë lumi – vjershe -*, a cura della Biblioteca G.Schirò di Piana degli Albanesi , Palermo 2002 (6)
391. **Schirò di Modica Giuseppe**, *Radhua i hapët mbi kulturën, gluhën e gojëdhënat arbëreshe*, Hora e Arbëreshëvet (Pa), 2006
392. **Schirò di Modica Giuseppe**, *Radhoi i sprasëm*, Hora e Arbereshëvet, Piana degli Albanesi, 2009 (65)
393. **Schirò di Modica Giuseppe**, *Radhoi i Arbërishtes te Hora – Manuale*, Hora e Arbëreshëvet-Piana degli Albanesi 2009 (67)
394. **Schirò Zef di Modica**, *Rarietà del lessico pianense*, Hora e Arbëreshëvet, dhjetor 2009 (66)
395. **Schirò Zef '38**, *Io, l'altro, forse nessuno – Poesie*, Hora e Arbëreshëvet, qershor 2010 (66)
396. **Schirò Giuseppe**, *Cenni sulla origine e fondazione delle Colonie albanesi di Sicilia*, - ristampa a cura del comune di Piana degli

Shënimet Bibliografike të Jetës Arbëreshe

(nn.1-72 / 2002-2011)

Albanesi – quaderni di Biblos, Rubbettino, Soveria Mannelli 1998 (31)

397. **Schmitt Oliver**, *Skanderbeu si Aleksandër i ri. Përvetësimi i traditës së antikitetit në Arbërinë e mesjetës së vonë*, in “Hylli i Dritës”, revistë tremujore themelue në vitin 1913 prej at Gjergj Fishtës, Shkodër 2007, nr.2 (57)
398. **Scilippa Marg**, *Re me rreze dielli - poezi dygjuhësh / Nivola con raggi di sole - poesia bilingue*, Pitti Edizioni, Palermo 2010 (69)
399. **Scuola Media Statale di Spezzano Albanese**, *Spixana, radici verdi...., per crescere insieme*, Medusa Associazione culturale, Grafosud snc, Rossano Calabro (Cs), 2009 (63)
400. **Scutari Enza** (përkthue në arbërisht), *Malli i shpirtit - poezi të zgjedhura të Lorca G., Ungaretti G., P.Neruda*, – përgatiti për shtyp N.A.Berisha, Tipolitografia Jonica, Trebisacce 2000 (4)
401. **Scutari Enza**, *Hënza fshehet prapa malevet*, poezi arbërisht me përkthimin italisht përballë, përgatiti për shtyp A.N.Berisha, Sfinga, Prishtinë 2000 (4)
402. **Scutari Enza**, *Il tempo degli angeli biancospini*, Eurostampa, Padova 2004 (25)
403. **Scutari Pasquale**, *I nomi delle piante nella comunità albanese del Pollino lucano*, Collana Studi e Testi di Albanistica, Università della Calabria, Tipolitografia grafica Cosentina, Cosenza 2005 (40)
404. **Scutari Pasquale**, *Il lessico della parlata arbëreshe di San Costantino Albanese*, Unical, Rende 2002 (24)
405. **Scutari Pasquale**, *Uno studio fonologico e morfologico sulla parlata arbëreshe di San Costantino Albanese*, tip.Benvenuto Città 2000, Cosenza 1997 (3)
406. **Sedaj Ëngjell**, *Shqipja arbërore*, Dardania Sacra, Prishtinë 2002 (9)
407. **Seiko Veis**, *Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*, Bargjini, Tirana 2002 (12)
408. **Selmani Ahmet** (përpilues), *Hapa nëpër natë, poezi*, Tetovë 2003 (20)
409. **Serembe Giuseppe**, *A Dio – canto polimetrico – Zoti, këngë shumëmetrike* (në shqip nga Xhevahir Spahiu), Botimet ideart, Tiranë 2004 (26)
410. **Serembe Giuseppe**, *Canti*, Amministrazione Comunale (a cura di Belmonte Vincenzo), San Cosmo Albanese 2007 (59)
411. **Skaltsi Panajotis I.**, *Matrimonio e Eucaristia – sussidi catechetici 33*, Besa Roma 2003 (23)
412. **Smaqi Laura**, *Zbulimi i vetvetes në pasqyrë t'letravet – pra e shkurtër e E.Koliqit*, Qendra e studimeve Albanologjike, sht.botuese Maluka, Tiranë 2009 (63)
413. **Staffa Felice Antonio**, *Opera Omnia – vol.I, Opere Edite*, a cura di Angelo Matrangolo e Aurora Stracan, (su iniziativa dell'Amministrazione Comunale di Falconara Albanese), Tipolitografia Gnisci, Paola (Cs) 2009 (63)
414. **Stamile Carmine**, *Raccolta del lessico arbëresh nel comune di Cerzeto – proverbi, indovinelli, bestemmie, giuramenti, benedizioni, auguri, modi di dire, ninne nanne, filastrocche, malattie più comuni, orazioni*, col patrocinio dell'Amministrazione Comunale di Cerzeto, Stab.Tip.De Rose, Cosenza 2011 (70)
415. **Stavileci Masar**, *Illuminizmi shqiptar*, Botime Toena, Tirana 2000 (11)
416. **Stratigò Anna**, *Luleborë (Bucaneve), Canti d'Arbëria e d'Albania*, cd in “Amadeus”, gennaio 2009 (61)
417. **Studi sull'Oriente Cristiano**, rivista diretta da Gaetano Passarelli, nr.9, Roma 2005 (44)
418. **Studime Filologjike**, (Akademia e Shkencave – Istituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), revistë tremujore, viti LVI, nr.1-2, Tirana 2002 (13)
419. **Studime Historike** (Akademia e Shkencave, Istituti i Historisë), revistë tremujore, viti LV, (1-2), Tiranë 2001 (3)
420. **Sulça Nijazi**, *De Rada, pinjollit arbëresh, poezi -*, Ankara 2008 (61)
421. **Shala Kujtim M.**, *Shenjat e tekstit*, Konica, Prishtinë 1999 (8)
422. **Shkurtaj Gjovalin**, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë 2006 (53)
423. **Shqipëria etnike**, revistë kombëtare mujore: informative-kulturore-politike, Looslistrasse 58, 3027 Berna-Svizzera, nr.17-18-19, 2001 (16)
424. **Tartaglione Leonardo**, *Poezit – Le poesie*, con il patrocinio del Comune di Ururi, Grafiche Arcobaleno, Ururi 2005 (41)
425. **Tartaglione Leonardo**, *Poezit, i dyti libër / Le Poesie, secondo libro*, opera realizzata col patrocinio del Comune di Ururi, tipolitografia Fotolampo, Campobasso 2009 (64)
426. **Të fletë Mashqitës Arbëreshë – Il foglio di Maschito, foglio bilingue di cultura linguistica e attualità degli Arbëreshë di Maschito**, direttore Umberto Volpe, anno I, nr.0, 2005 (40)
427. **Tocci Onorato**, *Da Rossano alla Città celeste - In viaggio con San Nilo nella Calabria bizantina*, Edizioni Brenner, Cosenza 2005 (41)
428. **Trapuzzano Camillo**, *Il costume femminile di Gizzeria*, Stampa Sud, Lamezia Terme 2005 (37)
429. **Trembelas Panajotis**, *L'anafora ad alta voce*, Besa, Roma 2003 (18)
430. **Trupo papas Antonio**, **Bruno Vincenzo**, *La Chiesa di S.Maria Assunta – Civita*, (immagini di Emanuele Pisarra), II edizione, Rubbettino, Soveria Mannelli 2007 (53)
431. **Trupo Antonio**, *Typikà parrocchiali nella Chiesa Arbëreshe*, a cura di Agnese Jerovante, Sussidi Catechetici, Besa, Roma, 2007 (54)
432. **Turano Giuseppina**, *Tratti linguistici e culturali dell'Arbëria crotonese*, Università della Calabria, Centro editoriale e librario, Rende 2001 (45)
433. **Typikon dei Monaci Basiliani di S.Maria di Grottaferrata**, Monastero esarchico di S.Maria di Grottaferrata, ed.Bannò, Frascati 2001 (5)
434. **Università degli Studi di Napoli “L'Orientale”**, (a cura di I.C.Fortino), *Albanistica Duemiladue*, tip. Zaccaria s.r.l., Napoli 2002 (52)
435. **Università degli Studi di Napoli “L'Orientale”**, (Dipartimento di Studi sull'Europa Orientale), *Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura*, - Atti del Convegno Internazionale, Napoli 1-2 dicembre 2005, (a cura di I.C.Fortino e E.Çali), Napoli 2008 (59)
436. **Università “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit**, *Përmbledhje me studime për Kostandin Kristoforidhin* – atti della Conferenza Scientifica Internazionale su Kostandin Kristoforidhi, Sejko, Elbasan 2002 (14)
437. **Università i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë**, *Filologji II*, Prishtinë 2003 (30)
438. **Università i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë**, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë gusht 2001, 2 vëllime, Prishtinë 2002 (23); Prishtinë, gusht 2002 - 2 vëllime -, Prishtinë 2003 (18); Prishtinë gusht 2003, 2

Shënimet Bibliografike të Jetës Arbëreshe

(nn.1-72 / 2002-2011)

vëllime, Prishtinë 2004 (42); Prishtinë gusht 2005, II vëllime, Prishtinë 2006 (55); Prishtinë gusht 2007, nr.26/1-2, Prishtinë 2008 (59); Prishtinë gusht 2008, 2 vëllime, Prishtinë 2009 (63); Prishtinë gusht 2009, 29/dy vëllime, Prishtinë 2010 (71)

439. Universiteti i Prishtinës, Istituti i Historisë, Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912), përpiluar nga Nevila Nika, Prishtinë 2003 (30)

440. Uri – Il Tizzone, organo del Bashkim Kulturor Arbëresh, anno VI, nuova serie, nr.4, Spezzano Albanese 2002 (7)

441. Vaccaro Attilio, I Greco-Albanesi d'Italia – regime canonico e consuetudini liturgiche (secoli XIV-XVI), Argo, Lecce 2006 (49)

442. Variboba Giulio, Gjella e Shën Mëris s'Virgjër, edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, Rubbettino, Soveria Mannelli 2005 (42)

443. Vinca Agim, Fije te pakëputura, Pro Kultura, Shkup 2004 (33)

444. Vinca Agim, Kënga e hapur; Antologji e komentuar, Albas, Tiranë-Tetovë, Prishtinë 2009 (64)

445. Vorea Ujko, Opera Letteraria (a cura di I.C.Fortino, A.Giordano, K.Zuccaro), Ed.II Coscile, Castrovillari 2004 (25)

446. Xhiku Ali, Duke lexuar letërsinë e traditës, Dituria, Tirana 2003 (14)

447. Zabjek Aleksandra, Studi in onore di Aleksander Wilkon, Università degli Studi di Napoli l'Orientale, Napoli 2005 (44)

448. Zavaroni Angelo, Il Collegio Corsini di San Benedetto Ullano, prefaz.di Francesco Russo, trad. e postfazione di Domenico Morelli, Edizioni Brenner, Cosenza 2001 (1)

449. Zuccaro Caterina, Bruno Vincenzo, Hapa të guximshëm në prozë, in "Ars", revistë letrare shqiptare, Tirana 2005 (34)

450. Zuccaro Kate, Zëmra e dheu, poezi, Ars Poetica, Tetovë 2006 (50)

Libre dhe Revista

Giordano protopapas Emanuele, Mesha e të Parashëjtëruarvet, Projazmena e pjerrë arbërisht, si dorëshkrim/pro manuscripto, Purçill/Eianina, Natallet 2011

Zoti Manuell mbaroi të parin redaktim arbëresh të *Meshës të Parashëjtëruarvet*, liturgji që thuhet ndër 6 javat e Kreshmevet, tek të mërkurtat e të premtat. Një arbërishte standarde, kuj, këtu këtë, i gërshetohen fjalë të marrë hua ka shqipja. Pas *Vangjelit*, *Shërbesës së Orëvet*, së *Lutjesores*, së *Mbrëmësores së Madhe*, së *Shërbesës së Varrimit*; pas *Vangjelljarit dhe Epistollarit*, që tjetër pjesë liturgjike bixantine do të pjerrë arbërisht nani zoti Manuell? Ju e thomi tek nr. 73 i Jetës.

Elmo Italo, La Storia di San Benedetto Ullano e Marri attraverso le fonti documentarie (Il castello di Rocca - itinerari culturali del medioevo ullanese) - vol.I: dall'età preistorica al XV sec.; vol.II: dal XVI al XX sec., (edito col patrocinio culturale del Comune di San Benedetto Ullano), pp.1727, Arbatialia Editrice, Agm, Castrovillari 2011

Autori, shënbenedhijtët, i ngrën një monument historik katundit të tij me dokumente të "dorës së parë". Kërkimet i bëri ndër Arkivet dhe Bibliotekat e Spanjës, Talljes dhe Vatikanit; të Shtetevet e të Qishavet, të Bashkivet e të Dioqesavet, të Abacivet, të Privatëvet, të Notarëve. Kërkime ç'ka epoka prehistorike njera te shek.XX. Dy vëllime të shkruar me kompetencë e me zëmër.

Gallo Giuseppe, L'Arbresh di S.Marzano, Adriatica Editrice Salentina, Lecce 2009

Autori është një arbëresh që lëngon shumë ture parë si gjuha e tij (e folmja e katundit të tij) vete ture u shuar. Për këtë mbjoth gjithë leksikon arbëresh që mundi. Shën Marcani sot qëndron i vetmi katund i provincës së Tarantit ku folet adhe arbërishtja. Ky libër është një dokument historik kulturor me vlerje: patjetër do të interesonjë gjuhëtarë e leksikografë.

Manali Pietro (a cura di), *Miscellanea Arbëreshe - Quaderni di Biblos - Società e Istituzioni 30/6*, Eurografica s.r.l., Palermo 2011 Ky është i tridhjetëti libër që, mbrënda pesmbëdhjetë vjetsh, u botua si "fletore të Biblos", mbrënda aktivitetit kulturor të Bashkisë së Horës së Arbëreshëve dhe të "Bashkimit të Bashkivet Besa". Të sprasmin studim të kësaj "Përmbledhje Arbëreshe" e shkruajtë korrispondentja jonë Demetra Giuseppina Schirò, me titull:"Il costume tradizionale femminile di Piana degli Albanesi: fonti iconografiche".

Bruno Pasquale, Celestino Margherita, Viaggio in Arbëria, guida attraverso gli itinerari turistico-culturali dei paesi arbëreshë della Calabria, Edizioni Prometeo, Castrovillari 2001

Është një libër që del tek viti kur dhjetra mijë Shqiptarë peshtojën ka Mëmëdheu i tyre për të gjetur gjetkë punë e paqe. E dhaj këtyre vëllezërve shqiptarë autorët - që rojën Frasnitë - i dhurojën këtë libër, që folën për Arbëreshët e Kallabris, që peshatuan ka Shqipëria, 5 shekul prapë, për mos të bijin ndër duart e Turqvet dhe të birjin lirinë e besën e krishterë. Libri - i zbukuruar me fotografi, me skeda

itinerarësh turistikë - është i shkruar për turistët e për gjithë ata që do të venë e vizitohen këta katunde arbëreshë.

Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale dell'Università di Napoli L'Orientale, (a cura di), Santori Francesco Antonio, *Sofia e Kominatëve*, romanzo, editio princeps a cura di Merita Sauku Bruci, saggio introduttivo di Italo C.Fortino, vol.I^o, Napoli 2011

Autorja, filologe e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Tiranës, siell në dritë këtë roman të Santorit, të pabotuar njera sot.I pari roman i letërsisë shqipe. Një vepër që pritej ka shumë e që vjen e mblon një mbrast në historinë e prozës dhe të letërsisë shqipe në përgjithësi. Te ky i pari vëllim, kemi tekstin arbëresh dhe aparatit kritik; i dëjti vëllim, që do të dalë këtu e pak, do të përmbanjë tekstin italian të romanit dhe konkordancat e leksikut.

Buzëdhelprri/Agostino Giordano, Bota Arbëreshe - Për ty Arbëresh - poezi - (përgatiti për shtyp Gjovalin Shkurtaj), Shtëpia Botuese Afërdita, Tiranë 1997

Pas *Hroaza* (Castrovillari 1971) e *Hapa mbi kalldrëm* (Shkup 1976), ky është i trejti libër me poezi i Buzëdhelprit, drejtorit të *Jetës*, e përmban edhe poezi të vëllimevet të mëparshëm. Gjuha është shqipja, mëshpjet se arbërishtja. I përgatitur nga prof.Shkurtaj, libri ka po ndryshe gabime. Njeng shkon dhe gjithë poezitë e Buzëdhelprido të jenë mbledhur te një libër i vetëm, dhe të pjerra arbërisht.

Në fillim të Jetës

Procesi kulturor, gjatë historisë së shoqërisë njerëzore, na ka provuar shpesh se ka disa nisma, të cilat edhe nëse do pushonin së ekzistuari, në fakt, kanë vetëm fillim dhe jo fund. Kjo lidhet me masën e veçantë dhe cilësore të prurjes që ato kanë shënuar në një kulturë të caktuar. Prandaj atyre nismave u përkujtohet vazhdimisht përvjetori i krijimit, qoftë edhe kur rreshtin së ekzistuari. Nuk ka gjë më të rëndësishme se të përkujtohet krijimin e tyre ndërsa ato ende ekzistojnë dhe kështu t'i inkurajosh për më tej. Jeta Arbëreshe është një nismë e tillë për kulturën arbëreshe aktualisht. Kjo revistë na ka bërë të gjithëve një dhuratë të çmueshme me 72 numrat e saj të deritanishëm. Nuk dimë, fatkeqsisht, a do të marrim të tjerë dhe a do kemi fatin të gjejmë, në kutitë tona postare apo në postën elektronike, numrat e ardhshëm të saj dhe as nëse do të jenë aq të shpeshtë sa deri tani. Në krye të një kohe kaq të gjatë pune dhe përkushtimi, mbi të gjitha nga ana e drejtuesit të kësaj reviste, A.Xhordanos dhe tërë bashkëpunëtorëve në viset arbëreshe dhe shqiptare në Shqipëri, Kosovë etj., pa dyshim që gjithsecili nga ne që kemi pasur kënaqësinë të botojmë pjesë të punimeve tona tek kjo revistë ndiejmë kënaqësinë dhe detyrimin e çmuar moral për ta përhëndetur këtë revistë, për ta falenderuar për punën e jashtëzakonshme dhe tërë dedikimin që ka dëshmuar ndaj kulturës shqiptare arbëreshe në këto 10 vjetë, e më së fundi, që ta inkurajojmë me gjithë sa mundim që të vijojë të jetë pjesë e impenjimeve dhe e interesave tona studimore në fushën e albanologjisë. Prandaj unë mendoj se në të vërtetë Jeta Arbëreshe nuk duhet të ketë një fund, ajo duhet të njohë vetëm vazhdimësi ndonëse në forma të ndryshme e të larmishme. Për këtë vazhdimësi të deritanishme të Jetës, personalisht ndjehem falënderuesi.

Faqet e Jetës kanë sjellë materiale letrare konkrete dhe të pazëvendësueshme nga folklori arbëresh dhe kjo revistë ka bërë pjesën e vet të dallueshme për ta ruajtur këtë pasuri të pasohqë të kulturës tonë kombëtare, por që njëkohësisht përbën edhe një fenomen të më vete në kulturën botërore. E them këtë pasi kjo pjesë unike e kulturës tonë ka ekzistuar dhe vijon të ekzistojë në kushte tërësisht specifike dhe duke ruajtur trajta të vetat në pamjen e tyre të para 500 vjetëve; një imazh gjysmë mijëvjeçar i një gjuhe dhe i një kulture letrare, e cila vjen e gjallë si formë jetese që frymon në terren e jo që prehet arkivave. Nuk di nëse ne shqiptarët duhet të ndjehemi më shumë krenarë apo të bekuar për një pasuri të tillë të kulturës sonë.

Në faqet e Jetës kemi gjetur po ashtu shkrime mbi punën e studiuesve arbëreshë në kohë, e sidomos në shekullin e XX. Ato janë një burim i rëndësishëm orientues për kërkime të mëtejshme qoftë nga studiuesit letrarë, nga gjuhëtarët, nga etnofolkloristët, antropologët, sociologët e kulturës etj. Dhe po kaq të pranishme kanë qenë në këto faqe edhe vëzhgimet mbi

dr. Baviola Shatro

Universiteti "A.Moisiu", Durrës

letërsinë dhe kulturën e sotme shqiptare brenda Shqipërisë, në Kosovë e kudo në trojet etnike. Aty janë pasqyruar rregullisht edhe aktivitete të rëndësishme akademike mbi kulturën shqiptare, si Seminari Ndërkombëtar i përvitshëm i Prishtinës. Faqet e vogla të Jetës kanë qenë mjaftueshëm të mëdha për të na paraqitur dëshirën e madhe për jetë që ka një gjuhë, një kulturë, një komb.

Dhe kjo këmbëngulje plot 10 vjeçare e Jetës për të mund të sjellë tek ne frymën e gjallë të kulturës tonë, veçanërisht në viset arbëreshe, është një thirrje e pangatërrueshme për cilindo që mundet të dëgjojë dhe që di të mendojë mëvetësisht. Kjo do bënte që shumëkush të mbështeste këtë nismë kaq të respektueshme dhe të rëndësishme, në mënyrë që ajo të mund të vazhdojë. Dhe kjo mbështetje nis që nga inkurajimi, që nga shmangia e indiferencës absurde që vihet re jo rrallë dhe që, sado nevojë për përmirësim të ketë Jeta, është më mirë të kontribuosh për ta përmirësuar atë sesa të qëndrosh në heshtje të plotë. Mund të kontribuohet gjithashtu edhe me ide, me shkrime, me forma të mbulimit të kostos për shkrimin dhe shpërndarjen e saj dhe, pse jo, ndoshta të punohet që ajo të kthehet në një periodik studimor albanologjik ku të gjithë ne anëtarët e trupës akademike në universitetet shqiptare brenda e jashtë Shqipërisë, të gjejmë terrenin e duhur dhe të pasqyrojmë gjerësisht punën tonë shkencore.

Nëse këto duken të pamundura, kjo nuk do të thotë aspak se realisht janë të pamundura. Fundja po aq e pamundur mund t'i dukej cilitdo në fillim edhe fakti që kjo Jetë, modeste por e gjallë, do hynte në ekzistencë dhe do mbushte tashmë 10 vjet që ekziston, që botohet rregullisht dhe madje që është mbajtur në këmbë nga puna organizative e një njeriu të vetëm, por që për fatin e të gjithëve ne, iu përgjigjën edhe autorë arbëreshë apo shqiptarë. Prandaj Jeta është një fakt që flet më shumë nga sa mund të mendohet duke na e ndryshuar perspektivën mbi gjërat e mundura apo të pamundura në këtë fushë.

Në këtë 10vjetor të Jetës, unë kam dëshirë t'i uroj asaj të vazhdojë të krijojë e të gjenerojë jetë nga vetvetja; dëshiroj të shpresoj se ajo do të shoqërohet nga gjithnjë e më shumë revista nga bota arbëreshe dhe më gjerë, dhe se do të vijojë të mbesë një burim ku ata që duan ta njohin fenomenin e rrallë shqiptar të kulturës arbëreshe përherë të mund të kthejnë kokën me bindje se do të gjejnë materien dhe shtysat që u duhen në punën e tyre. Si e tillë Jeta është e destinuar të vazhdojë..

Sen. Basilio Giordano

3^a Commissione - Affari Esteri, Emigrazione
Vice Presidente Comitato Italiani all'Estero

Piazza Madama, 1 – 00186 Roma

Tel. (+39) 06.6706.3174 • Fax (+39) 06.6706.6174
basilio.giordano@senato.it • www.basilioigiordano.com

Jeta Arbëreshe (abonim)

+

Fjalor i Arbëreshëvet t'Italisë

i Emanuele Giordano - s

€uro 50

Ka liqë tata...

Demetra Giuseppina Schirò

mësuese, ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Prufisur Xhordano, te këta vjet, ngë ka më lën këmbë: thërret te biblioteka, thërret te shpia, thërret te gjithonia ...për *Jetën Arbëreshe*, kaq e ca më shumë.

Prëmë më dha nduhtën e mirë: Jeta Arbëreshe buri dhjetë vjeç! Si e gjegji mëma: "E çë po mua më rriten vjeçët?"

Jeta na vrehet te pasqira ka ndo fill kripi i bardhë; vuri oqajët (të zgjidhet i duhen sitë e "Sënta" Luçisë) ... por isht *gjallë*e, kush isht *gjallë* ka venj përpara.

U te kjo rivistë kam shkruar me arbreshin çë flitet te Hora e Arbëreshëvet; te kjo e folme shumë herë vijën jashtë shprehje të qëruame çë me një herë të kujtojen kush je; si dimë, Arbërishtja pati të përzihej me dialektin siçilian të mos jipëj sakat, e prindrat tanë (pa skollë) morën atë çë i duhej pa shtipur lakimin e gjithë rregullat të gluhës. Na përçë ngë mënd bujëm si ata? Ka liqë tata kur thot se skollët çë kemi ngrah janë gjithë *'njuranca'*

Eparkia, Universiteti, Skolla, Biblioteka ka ngrëjën mëngët e prindrat ka ndëlgojën se, na të bijt mësojën gluhën e tire, kjo ngë zëhet me tjerat gluhë po i zbill më shumë trutë. Pranë, na bijtë i kanë "turdunëra", isht njetër diskurs.

Prufisù, sa lik të dua: mos buj Kuvende mos na danj mjekrra (edhe kjo më lipset); buj një bukur festë!

Urime për Jetën! E ditë me shëndetë tij çë, si prind, e ke rritur!

Një burri me dy jetë

Mario G.Miracco/Motimadh

kok, ka Shën Sofia (Cs)

Moti je liqë atij burri çë kur shurben ruan çë te tala e drelart, pse ai ruan atë çë ka t'bnëj, dhe atë ç'ë pa bën.

E ka t'keç te gjaku mall e brugam sa t'mbaç të gjella besen tënde, ajo besë çë të ndan ka të tjerë.

Prof. Agostino Giordano, Drejtor i Jetës Arbëreshe, të fala dy herë!

Një, per jeten tënde: paç urat e shëndetë ka Shën Bombini për një qind vjet!

Dy, për Jeta Arbëreshe, çë simbjat bën dhjetë vjet: çë bën nderë Arbërisë, çë je vuxhë gjithë atire çë ndienjen te zëmra historinë çë lërien prindët.

Gusti, mos lërë të mbullighet kjo dritësore arbëreshe te një qiell i ylëzuar!

Shkuan dhjetë vjet

Angelo Matrangolo

mësues/sportelist, ka Firmoza (Cs)

Një ditë u mbjodha më shpi e mëma më tha se një çikë mënjehere kish shkuar një burr leshbardhë, një gjiri arbëresh, një purçilot. Më tha: «Sonde mos dil fare pse ki gjiri do të prirret njetir herë se ka ti të fjas pir një shurbes çë do të ndërronjë jetin e Arbëreshvet».

U pir orë e orë pënxova se kush mund ish ki burr, ki gjiri, se si thojë mëma.... Kur gjithënjeheri gjegja se njeri ish mbë derë, hapa e çë pe? Ish Gustini.

Na rrëfajti se kish nxë të bëni një rivistë e shkruar arbërisht, ma Firmozë kish gjetur vetim dy vetë çë i kishin taksur se do të shkruajin... po vet shqip, e Gustinit ki shurbes ng' i pilqeni fare. Më tha se ai doj njeri çë shkruanej se si fjitej Firmozë e nga katund kirkonej një çë shkruanej pir katundin e tij.

U, i trëmbur, i thash se ngë isha i zoti të bënja mirë kit shurbes, po ai kocëngurtë (Gustini) më la Fjalorin e lalës e më tha: "Zë e shkruaj!"

Shkuan dhjetë vjetë e u dalë e dalë shkruajta atë çë ndodhi Firmozë, herë të mirë e hereherë jo, po vetim sod mund thom se idea e Gustinit ish, e qindron, e këndshme: e vetmja rivistë çë fjet arbërisht e i fjet arbëreshvet.

U çë isha, edhe jam, i marr ka gjërat të bukura çë shkruan Nando Elmo, i cili me personaxhet e tij shumë herë në mende time u bënë të virtet, me kallëzimet e tij të argalisura si vetim ai di, gjuturova vendet çë ai me sfumaturat gjuhësore e urtësi na jep.

Ndir këto dhjetë vjetë meritova një shurbes, gjë e madhe pir mua, një "më pilqen" ka Nandini i Helmit. E këtë mundësi m'ë dha "*Jeta Arbëreshe*".

Faleminderit e Urime!



Urime Jetës Arbëreshe

prof. dr. Tomor Osmani

Instituti i Studimeve Albanologjike
pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi",
Shkodër

Një ndër revistat që po qarkullon vitet e fundit në Eianina/Purçill (Cs-Italia) është "*Jeta Arbëreshe*", një botim tremujor i pakicave gjuhësore, historike të shqiptarëve të Italisë, e cila sot me nr.72 feston 10-vjetorin e saj, një krenari e ligjshme e stafit drejtues. Ajo është bërë një organ i dashur dhe i pëlqyer nga lexuesit e saj.

Një ndër vlerat e saj është se revista nuk është lokalizuar në një mjedis të ngushtë bashkëpunëtorësh, por ka gjetur përhapje në gjithë hapësirën shqipfolëse. Duke shfletuar numra të ndryshëm të këtij organi vëmë re se rrethi i autorëve vjen e zgjerohet jo vetëm nga Kalabria apo Sicilia, por edhe nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e gjetkë. Puna e stafit dhe e drejtorit të saj Agostino Giordano është për t' u lavdëruar, pasi po e mban gjallë këtë rivistë duke ruajtur periodicitetin prej katër numrash në vit dhe duke përmirësuar cilësinë. Rubrikat që mban revista dhe informacionet që jep, e afrojnë më shumë me lexuesin arbëresh dhe atë shqiptarë, gjë që i mban të gjalla lidhjet me atdheun mëmë. Struktura e revistës është e gjetur: një kryeartikull dhe pastaj rubrika të veçanta me karakter studimor nga fusha e gjuhës, letërsisë, folklorit, historisë etj., duke përfshirë edhe materiale të mbledhura në terren. Sigurisht që pjesa më e madhe e shkrimeve ka karakter divulgativ, por ne ndeshemi edhe me shkrime me karakter të mirëfillt shkencor.

Stafi i revistës duhet përshëndetur pasi boton edhe folklor dhe fjalorë të arbërishtes. Ideja jonë është që në këtë organ, duhet të zënë një vend të rëndësishëm materialet origjinale folklorike, gjuhësore, letrare dhe historike për t' i shpëtuat zhdukjes së tyre.

Revistës "*Jeta arbëreshe*" dhe stafit, në përvjetorin e dhjetë të saj, i uroj suksese që të popullarizojë me dinjitet kulturën arbëreshe në faqet e këtij organi dhe të jetë një përçuese e aftë tek lexuesi për të pasqyruar arritjet e botës arbëreshe në të gjitha fushat e jetës.

Vdekja dhe ringjallja e Gjuhëvet**prof.dr.Italo C.Fortino**

shënbendhitjot, Università "L'Orientale, Napoli

1. Pse vdesin gjuhët?

Jo gjithë dinë se nga vit vdesin, vjen me thënë se nëng fliten më, foka 25 gjuhë. Ndë të sprasmët vite, gjuhët vdesin më njiye pse jeta u ndërrua e ai fenomen që ja thonë globalizëm favorirën gjuhët e forta e lë të vdesin ato gjuhë që neng kanë një funksionë komerçale.

Gjuha arbëreshe, ajo që flitet ndë katundet arbereshë të Talljes, nëng ka një funksionë komerçale, po ajo ka një funksionë kulturele, një funksionë afetive, një funksionë që lidhet me familjen, me katundin-

Kjo funksionë sodeparë – pas krizës që jem`e gjëllijim ndë keto ditë ndë Tallje e ndë Europë – mund bëhet më e ndiejtur, mund na tërheq me më shumë fuqi, mund na suxherin që eshtë mirë të vlojm e të mbajim mirë atë kulturë e atë gjuhë që kemi që kur u lemë. Vjen me thënë se kriza e ekonomisë mund na tregonj se ka vlera që janë më të forta se ekonomia e se komerçi; ka vlera që i ngasin zëmrës, vlera që lidhin trimin me pridët e me tatmëdhenjtë e me mëmëmëdhatë. Shpëtohet kështu kontinuitata kulturele e gjeneracionave: me një fjalë fëmijët e trimat rriten ndë armoni me kulturën e katundit, që është si një bazë mbi të cilën ata pra ndërtojin kulturën e jetës së sotme italiane, europiane. Se na sod jemi jo vetëm bij të katundit tonë, po jemi bij të Talljes e të Europës.

2. Si mund shpëtohet një gjuhë e një kulturë që është e vdes?

Gjithë dimë se ndë motin tonë raportit që lidhën fëmijët me prindët e me prindët e prindëve është e laskohet ngaherë më shumë, kështu se edhe gjuha nëng trasmetiret si më parë ndë ambientin familjar. E pra që ka të bëjm të ja trazmetirim fëmijëve, djemve,, trimave, me një fjalë xheneracionave që vijin?

a. Skolla

Sod skolla mund bënj atë që nëng arrvon të bënjë më familja. Kjo vjen me thënë se skolla ka të mbësönj gjuhën e kulturën arbëreshe (storien, literaturën, folklorin, muzikën, arkitekturën) ndë manerë sistematike, gjatë gjithë vitit të skollës, ture u nisur që nga vjeshta e njera te theristiu, ndë orarin që kanë të tjerat materje. Thonë ata që studjartin problemin e gjuhëve se, ndëse mbësohen mirë, edhe gjuhët që janë e vdesin mund shpëtohen. U shpëtua kështu gjuha e popullit që ja thonë "Maori" e që jeton ndë Nuova Zelanda.

b. Vulundata e njerzëve

Gjindja që bën pjesë ndë një komunitat që flet një gjuhë që është e vdes, sa mund shpëtohet ka të ketë vulundatën të njohë kulturën e të flasë gjuhën e prindëve. Këtu intelektualët mund bëjin shumë ture valorixartur gjuhën e kulturën e ture i thënë tjerëve se është mirë të mbahet kultura ku u kemi lerë. Rivistat ka të shkruajn nga herë për këtë problem artikuj të shkurtura që mund i ndiojin gjithë. Pfrifrat, që rrinë shumë mot bashkë me gjindjen e katundit, mund flasin ngaherë arbërisht e mund predikojin arbërisht. Sindkat mund bëjin edhe konxiljet komunale ture folur arbërisht e sportellistat ka të jenë arbëreshë që dinë e flasin shumë mirë arbërishtjen e vendit ku shurbajn.

c. Çë mund bëjin Politika e Qisha

Ata që mirren me politikën ka të impenjohen të difenxojin kulturën e katundeve arbëreshe. Si? Ndë vendin e parë ture folur edhe ata gjuhën e katundit, pra ture marrë provedimende ndë favor të kulturës e të gjuhës së katundit e, si shkruajta lart, ture folur

edhe ndë Konxilet gjuhën e katundit.

Qisha mund bënj shumë pse ka shumë kontate me njerzët: mesha ka të thuhet arbërisht nga dita. Vangjeli mund djovaset arbërisht nga dita, pse e kemi arbërisht: "Vangjeli" (i pjerrë arbërisht nga zot E. Giordano, 2006). E kemi librin e meshës arbërisht: "Liturgjia hyjnore e Atit tonë ndër Shejtrat Joan Hrisostomit" (Roma 1967). Edhe katekizmi mund i mbësohet arbërisht fëmijëvet. E kemi katekizmin arbërisht: "Besa e krishterë" (Besa, Roma 1992).

d. Çë mund bënj revista "Jeta Arbëreshe"?

Na sod ka t'i rikonoshirim, ka t'i njohim një meritë kësaj riviste: ndë pjesën më të madhe është e shkruar arbërisht. Ki fat ka shumë mbortanxje: a) i jep dinjitatë gjuhës së katundit, b) ndihën gjindjen sa të konsiderarinj gjuhën që fjet si të tjera gjuhë, c) shtie intelektualët të shkruajn gjuhën e ture, i jep fuqi të përvojin të shkruajn arbërisht si flasin, d) mund ketë influenxë të mirë ndë gjithë ata që e djovasin sa të ndiojin se është mirë të shpëtohet një gjuhë që u fol nga motët e vjetër, e) rritën sentimentin që na lidhën me kulturën tonë e na shtin të flasin gjuhën tonë.

e. Si ka të jetë revista "Jeta Arbëreshe"?

Rivista ndë gjuhën italiane ka; revista ndë gjuhën shqipe ka. "Jeta arbëreshe", pra, ka një funksionë që rivistat italiane e rivistat shqipe nëng kanë: të shkruanj ndë gjuhën që flitet ndë katundet arbëreshë. Pra të shkruhet ndë gjuhën e folur, ndë gjuhën që kur e djovasin e ndiojin, e të shkruhet për probleme që i ngasin kulturës arbëreshe. Kështu mund ndihen edhe ata që mbësöjin gjuhën arbëreshe ndë skollat. Për këtë, kjo rivistë ka t'i dërgohet mësemë atire që janë të impenjartur ndë skollë për të mbësöjin gjuhën e kulturën arbëreshe. Është nje rivistë që me skollën ka të ketë një raport prioritar, pse skolla sodsisod është vendi ku tranzmetiret kultura.

f. Çë mund djovaset mbi këtë argumend?

Ata që nëng kanë besë se një gjuhë, që është e vdes, mund të shpëtohet nga vdekja, mund jetë mirë të djovasin librin e studiozjt françez Claude Hagège, *Halte à la mort des langues* (Éditions Odile Jacob, 2000).

Spërënxa jo vetëm se nëng shuhet, po përforcohet e bën e rritet konvixiona se edhe kulturat e vogla, si edhe gjuhët e vogla, kanë të drejtën të rrojin me dinjitet. Këto gjuhë e këto kultura i japin një kontribut të madh formacionës së njeriut: djemtë e trimat, si vajzat e kopilet, kanë të rriten me një kulturë të gjerë europiane, ture njohur gjuhët e mëdha europiane, po edhe me respektin e kulturës dhe të gjuhës që kanë mbësuar ndë katundin e ture. Kështu ata njohin jetën e jashtme, europiane, po edhe jetën e mbrëndshme, arbëreshe, atë gjuhë që i lidhën me gjiritë, me gjithë të mirat që i vijin nga trungru i familjes e i katundit.

Jeta Arbëreshe**(10 vjet: 2002 - 2011)****72 numra, 1.344 faqe**Gjuhë, Letërsi, Histori, Folklor e Lajme
ka Arbëria e ka Bota Shqiptare**450 euro**

(për Institucionat, 650 euro)